



## VAKSINA KUNDËR COVID-19

# Informacione të përgjithshme për vaksinimin kundër Covid-19 me vaksinën vektor të Janssen

### A është vakcina efektive dhe e sigurt?

Çdo vaksine në Zvicër i nevojitet një aprovim. Për këtë gjë duhet që ajo të përmbushë kërkesa të larta për sa i përket sigurisë, efektivitetit dhe cilësisë. Instituti Zviceran i Barnave Swissmedic ka kontrolluar dhe aprovuar me kujdes vaksinat kundër Covid-19. Ato janë të sigurta dhe efektive.

Në rastin e vaksinës vektor të Janssen, një virus i padëmshëm përdoret si mjet transporti (vektor), për t'i transmetuar qelizave tona udhëzime të rëndësishme mbi patogjenin. Me mijëra persona kanë marrë vaksinën vektor të Janssen gjatë studimit. Prej aprovimit u vaksinuan shumë miliona persona me këtë vaksinë. Specialistët vazhdojnë të monitorojnë sigurinë dhe efektivitetin e vaksinës. Dobia e një vaksine duhet që t'i tejkalojë qartësisht rreziqet. Vetëm atëherë kjo vaksinë këshillohet në Zvicër.

### Ku mund të vaksinohem?

Federata ka përgatitur një strategji vaksinimi dhe këshilla për vaksinimin. Përgjegjës për vaksinimin janë kantonet. Informohuni në faqen e uebit ose te linja informuese e kantonit tuaj ([www.bag-coronavirus.ch/kantone](http://www.bag-coronavirus.ch/kantone)), se ku mund të vaksinoheni. Ose pyesni mjeken tuaj, mjekun tuaj, farmacisten tuaj ose farmacistin tuaj.

### Kujt i këshillohet vakcina?

Ne ja këshillojmë vaksinën kundër Covid-19 me vaksinën vektor të Janssen personave mbi 18 vjeç, të

- cilët për arsye mjekësore nuk mund të vaksinohen me një vaksinë mRNA;
- që refuzojnë vaksinat mRNA.

### Kush nuk duhet të vaksinohet me vaksinën e Janssen?

Personave të mëposhtëm nuk i këshillojmë vaksinimin kundër Covid-19 me vaksinën vektor të Janssen:

- Personave me një alergji të rëndë të konfirmuar kundrejt një përbërësi të vaksinës.
- Personave të cilët kanë pasur një sindromë të rrjedhjes së kapilarëve (Capillary-Leak-Syndroms (CLS)).
- Të rinjve dhe fëmijëve nën 18 vjeç si dhe grave shtatzëna dhe grave që ushqejnë fëmijët me gji. Deri tani nuk ka mjaftueshëm të dhëna për përdorimin e vaksinës në këto grupe.
- Personave me sistem imunitar të dobësuar (për shkak të një sëmundje ose një terapie).

Ju lutemi mbani parasysh: Keni temperatur të lartë? Jeni i sëmurë dhe nuk ndjeheni mirë? Atëherë shtyjeni datën e vaksinimit.

Po prisni për rezultatin e testit tuaj Covid-19? Ose jeni në izolim ose në karantinë? Atëherë mos e bëni tani vaksinën. Bëjeni vaksinën më pas sa më shpejt të jetë e mundur.

### Çfarë vlen, nëse jam shtatzënë ose dëshiroj të mbetem shtatzënë?

Ne ju këshillojmë vaksinimin me një vaksinë mRNA.

Nëse jeni shtatzënë ose planifikoni të mbeteni shtatzënë dhe keni pyetje rreth vaksinimit, flisni me mjeken tuaj, mjekun tuaj ose maminë tuaj.

### Si kryhet vaksinimi?

Juve ju bëhet një injeksion në krah.

### Sa herë duhet të vaksinohem?

Nevojitet një vaksinë.

### Si më mbron vakcina mua?

Trupi juaj krijon një mbrojtje kundër Covid-19.

Kjo gjë zgjat deri në tre javë pas vaksinimit. Vakcina forcon forcat tuaja mbrojtëse. Ajo e ndihmon trupin tuaj që të luftojë kundër virusit. Rreziku që ju të infektoheni me Covid-19, reduktohet shumë.

Kjo është e rëndësishme për tu ditur: Mbrojtje të plotë nuk ka.

Disa persona megjithëse janë vaksinuar mund të infektohen me Covid-19. Por me vaksinën ato janë të mbrojtur shumë mirë kundrejt një sëmundje të rëndë. Prandaj testohuni menjëherë, nëse keni simptoma të Covid-19.

Këtu gjeni informacione më të sakta, se si funksionon vakcina: [www.bag-coronavirus.ch/vektor](http://www.bag-coronavirus.ch/vektor)

### Për sa kohë më mbron vaksinimi?

Për momentin specialistë po studiojnë se për sa kohë mbron vakcina. Mund të ndodhë, që më vonë të nevojitet edhe një vaksinë tjetër.

### A mund të infektohen me Covid-19 për shkak të vaksinës?

Jo. Nga vakcina ju nuk infektoheni me Covid-19.

Në vakcina nuk ka viruse korona.



## Duhet të vaksinohem, nëse kam qenë tashmë i infektuar me Koronavirus?

Vaksina bën sens edhe nëse ju keni qenë i infektuar tashmë me Koronavirus. Parimisht, pas një infektimi ju jeni i mbrojtur për një farë kohe kundrejt një ri-infektimi. Për sa kohë, nuk dihet. Por ekzistojnë indikacione, që personat e vaksinuar janë të mbrojtur më mirë kundrejt një infektimi. Prandaj ne ju këshillojmë vaksinimin, në mënyrë që të jeni i mbrojtur më mirë në termin afatgjatë. Vaksinohuni mundësisht brenda një deri tre muajve pas infektimit.

## Ka efekte anësore?

Te çdo vaksinë mund të ketë efekte anësore. Në shumicën e rasteve ato janë të dobëta deri të moderuara dhe kalojnë shpejt. Shumë radhë ka ndikime anësore të rënda. Kështu te disa persona të caktuar pati një reaksion alergjik të rëndë pas një vaksine kundër Covid-19. Nganjëherë, pas vaksinimit me vaksinën vektor të Janssen, brenda tre javëve të para pas vaksinës, u vëzhguan forma të rralla të trombozave (sidomos tromboza të venave cerebrale ose të venave abdominale por edhe tromboza arteriale) të lidhura me një mungesë të trombociteve. Këto ngjarje ishin me pasoja të rënda, por u shfaqën shumë rrallë (te 1 deri në 8 nga 1 milion persona) pas një vaksinimi me vaksinën vektor të Janssen. Përveç kësaj nuk ka anomali për sa i përket efekteve anësore më të rënda. Efekte të tilla anësore priten brenda pak muajve pas vaksinimit. Specialistët i monitorojnë me kujdes indikacionet e mundshme.

## Çfarë simptomash mund të shfaqen pas vaksinimit?

- Vendi në krah, ku u krye vaksinimi skuqet, dhemb ose është i ënjtur.
- Dhimbjet e kokës
- Lodhje
- Dhimbje muskujsh dhe gjymtyrësh
- Të përziera
- Simptoma të përgjithshme si të dridhura, ndjesi ethesh si dhe ethe të lehta

Këto efekte anësore shfaqen shpesh pas vaksinave. Ato tregojnë që trupi po ndërton mbrojtjen kundër sëmundjes. Pra në formë të butë ato janë një shenjë e mirë.

Në rastin e një reaksioni alergjik, direkt pas vaksinimit shkaktohet për shembull një ënjtje e fortë, skuqje, kruarje ose vështirësi në frymëmarrje. Simptomat tipike të trombozave janë hemorragji të vogla në formë pikash ose mavijosje të lëkurës (sidomos përtej vendit ku është bërë vaksina), gulçim, dhimbje gjoksi, ënjtje te krahët dhe këmbët, dhimbje të vazhdueshme barku, dhimbje të forta dhe të vazhdueshme të kokës ose shikim i turbulluar. Në rastin e simptomave të tilla drejtojueni menjëherë mjekes tuaj ose mjekut tuaj.

## Sa mund të zgjasin efektet anësore?

Efektet anësore zhduken normalisht pas pak ditësh. Keni ende efekte anësore pas një jave? Bëhen ato më të rënda? Apo shqetësoheni?

Atëherë flisni me mjeken tuaj ose me mjekun tuaj.

## Unë jam i vaksinuar. A mund të infektoj unë persona të tjerë me

### Koronavirus?

Pas vaksinimit të plotë, probabilitetit që ju të infektoheni me Koronavirus është shumë i reduktuar. Por vaksina nuk ofron një mbrojtje njëqind përqind.

Ju lutemi mbani parasysh: Vazhdoni të respektoni rregullat e higjienës dhe të sjelljes dhe detyrimin e mbajtjes së maskës, atje ku ai ekziston. Por: Nëse jeni plotësisht i vaksinuar, në takime private me persona të tjerë që janë plotësisht të vaksinuar, ju mund të hiqni dorë nga rregullat e ruajtjes së distancës. Në rastin e një kontakti të ngushtë me një person të testuar pozitiv, ju nuk jeni i detyruar të futeni në karantinë. Dhe në rast udhëtimi për në Zvicër, ju jeni i përjashtuar nga detyrimi i kryerjes së testit.

## Kush e paguan vaksinën?

Vaksina është falas. Sigurimet shëndetësore paguajnë një pjesë të vaksinës. Federata dhe kantonet paguajnë pjesën e mbetur.

## A është vaksinimi me bazë vullnetare?

Po. Vaksinat në Zvicër janë me bazë vullnetare. Kryerja me detyrim e vaksinave nuk është parashikuar.

## Ku gjej informacione të tjera?

Informacione të tjera mbi vaksinën kundër Covid-19 dhe mbi certifikatën Covid gjeni në faqet e uebit të BAG:

[www.bag-coronavirus.ch/impfung](http://www.bag-coronavirus.ch/impfung)

[www.bag-coronavirus.ch/zertifikat](http://www.bag-coronavirus.ch/zertifikat)

Ose pyesni mjeken tuaj ose me mjekun tuaj. Ose në farmaci.

